# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

**KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE**
**MAJ, VITI MËSIMOR 2016/17**

## UDHËZIM PËR VLERËSIM

---

**VËREJTJE: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.**

**DETYRA 1.**: është rrethuar numri 2. Që të shërbejë për pjesëmarrje në lojën shpërblyese.

***1 pikë***

**DETYRA 2.**: Nxënësi/nxënësja* merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar saktë të dy titujt:

**Kushti I:** llogaria më e madhe se 7 euro/tregton në shumë më tepër se 7 €

**Kushti II:** blerja e një ose më shumë prodhimeve nga brendet e theksuara (pranohet emërtimi i një ose më shumë brendeve)

**DETYRA 3.:** Që të mund ta informojnë për shpërblimin eventual të fituar

***1 pikë***

**DETYRA 4.:** Në teatër dhe restorant/ ngjarja zhvillohet në shfaqje dhe tek “Fojo-ja” *(dhe përgjigje tjera të sakta)*

***1 pikë***

***Vërejtje:***

*Nxënësi **nuk merr pikë** nëse ka shkruar vetëm një vend të zhvillimit të ngjarjes.*

**DETYRA 5.:** Për artin/për pikturën, letërsinë dhe muzikën/për gjendjen e dramës në Ballkan *(dhe përgjigje tjera të sakta)*

***1 pikë***

**DETYRA 6.:** Gjithsej ***2 pikë***

**A)** është rrethuar numri 2. retrospektive

***1 pikë***

**B)** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse shkruan: Tregimi fillon në momentin e tanishëm të rrëfyesit, pastaj rrëfyesit i kujtohet e kaluara dhe në fund tregimi përfundon në kohën e tashme/ndërrohen e tashmja, e kaluara dhe e tashmja *(dhe përgjigje tjera të sakta)*

**DETYRA 7. :** Nuk e ndjeva veten mirë kur e sollën menynë/nuk u ndjeva mirë... dhe zemra mu shtrëngua pak/mu shtrëngua zemra përsëri/mu shtrëngua zemra

***1 pikë***

**DETYRA 8.:** gjithsej **2 pikë**

**A)** 1. hyrja 2. zhvillimi

***1 pikë***

**B)** Paragrafi i fundit ose ndonjë fjali nga ky paragraf.

***1 pikë***

**DETYRA 9:** gjithsej **2 pikë**

A) Kohën e ardhme ***1 pikë***

B) Mënyrën dëftore ***1 pikë***

***1 pikë* –** nëse tregon ose kohën ose mënyrën e foljes

**DETYRA 10:** gjithsej **2 pikë**

A) Nxënësi ka rrethuar 2. Bileta vajtje-ardhje është më e lirë. **- 1 pikë**

B) Nxënësi ka argumentuar përgjigjen: Viza (lidhëse) është përdorur drejtë në bashkimin e dy antonimeve vajtje-ardhje **-** ***1 pikë***

***1 pikë* –** nëse ka rrethuar saktë ose ka argumentuar saktë përdorimin e vizës

**DETYRA 11:** gjithsej **2 pikë**

Nxënësi merr **2 pikë** nëse në vendin e lënë bosh ka shkruar shkronjën që duhet në mënyrë që fjala të jetë e shkruar saktë: sta**XH**ionim stërho**LL**oj; **Ç**ezmë; standar**D**izoj; drug**DH**endës

Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar saktë shkronjën që duhet në tri ose katër fjalë

**DETYRA 12:** gjithsej **2 pikë**

Nxënësi merr ***2 pikë*** për dy përgjigje plotësisht të sakta të funksionit sintaksor që kryejnë fjalët e nënvizuara në fjalinë: Ai dinte gjithçka dhe ishte i gatshëm të më shpjegonte gjithçka.

| | |
|---|---|
| gjithçka | *Kundrinor i drejtë (ose kundrinor)* |
| ishte i gatshëm | Kallëzues emëror (ose kallëzues) |

***1 pikë* –** për një funksion të saktë sintaksor që kryejnë fjalët e nënvizuara në fjalinë e dhënë

**DETYRA 13:** gjithsej **2 pikë**

Nxënësi merr ***2 pikë*** për përgjigje plotësisht të saktë:

1. Posa erdhi në shkollë filloi të ***përlahej*** me shokë.
2. E kemi parë mbi ***pullazin*** e shtëpisë.
3. Po as ti nuk u ndihmon ***atyre*** për të mësuar.

Nxënësi merr ***1 pikë*** për dy përgjigje të sakta.

Nxënësi merr ***0 pikë*** nëse ka shkruar saktë vetëm një përgjigje.

**DETYRA 14:** Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen plotësisht të saktë***:***

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| *Libri* | *i vogël* | *ndodhet* | *mbi* | *tavolinë* |
| *emër* | *mbiemër* | *folje* | *parafjalë* | *emër* |

**DETYRA 15:** Nxënësi merr **1 pikë** për kthimin e fjalisë së dhënë nga ligjërata e zhdrejtë në ligjëratën e drejtë:

*Mbreti i tha së bijës se tani zgjidhe dhuratën që të pëlqen më shumë dhe martohu me princin që e kanë sjellë.*

**Vërejtje:** ***për shkak të gabimit teknik në formulimin e pyetjes nxënësit t'i pranohet përgjigjja e saktë 1 pikë.***

**DETYRA 16.:** Gjithsej **3 pikë** (nxënësi merr nga 1 pikë për çdo përgjigje të saktë):

1. Letrar ***(1 pikë)***
2. Shkencor ***(1 pikë)***
3. Gazetaresk/publicistik/gazetaresko-publicistik ***(1 pikë)***

**DETYRA 17:** gjithsej **3 pikë**

Princ Rogani – "KURORA E MALEVE", P.P.Njegoshi

Marga – "E PUTHURA", Mihal Grameno

Tana – "KATËRMBËDHJETË VJEÇ DHËNDËR", A.Z.Çajupi

**1 pikë –** për çdo titull të veprës në të cilën paraqitet personazhi i dhënë dhe emrin e mbiemrin e saktë të autorit të saj

**DETYRA 18:** Gjithsej **2 pikë** (nxënësi merr nga 1 pikë për çdo përgjigje plotësisht të saktë – përgjigje të rrethuar saktë dhe shpjegim të shkruar saktë)

| CILËSITË | TË NJËJTA | ARGUMENTIMI |
|---|---|---|
| gjinia letrare | PO (rrethuar) JO | *Te dy poezitë i përkasin gjinisë lirike* |
| lloji letrar | PO JO (rrethuar) | *E para është elegji, kurse e dyta vjershë lirike patriotike* |

**DETYRA 19:** gjithsej **2 pikë**

**A)** *Se të deshte, kur s'të deshnin,*
*Se të qante, kur të qeshnin,*
*Se të veshte, kur të zhveshnin".*
**1 pikë** *(Nxënësi merr 1 pikë edhe nëse e ka shkruar një varg ku përdoret antiteza)*

**B)** *Ah, s'dua jo, kështu dë vdes,*
*mos, mos, o zot, më pre çdo shpresë!*

**1 pikë**

**DETYRA 20.**

**Skema për vlerësimin e hartimit *TALENTI IM I FSHEHUR/HAPUR***

**Përmbajtja – 10 pikë**

**Kërkesa 1.**

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse shkruan shkurt për çfarë është i talentuar, përkatësisht nëse shkurt i paraqet prirjet e veta për shkencë, sport, art....

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 2.**

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse përshkruan thjeshtë ndjenjat e veta derisa luan në ndonjë instrument, vizaton, zhvillon detyrat, mendon, përgatitet për gara....

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 3.**

Nxënësi:

merr 1 pikë në qoftë se shkruan shkurt se çfarë janë reaksionet e bashkëmoshatarëve dhe mjedisit për interesimet e tij.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 4.**

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse më thjeshtë përshkruan se është i gatshëm ose nuk është i gatshëm të punojë atë që do në kushte të vështira.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 5.**

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse shkruan se kush e mbështet në zhvillimin e talentit, përkatësisht kush do të dëshironte ta mbështete nëse do të merrte vesh për çfarë është i talentuar.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

***Gjithsej 2 pikë***

**Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë**

| Leksiku | Saktësia gjuhësore | Lidhshmëria | Struktura e tekstit |
|---|---|---|---|
| → të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, leksiku i pasur<br><br>***2 pikë***<br><br><br><br><br><br>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, leksiku i varfër dhe përsëritja e shprehjeve<br><br>**pjesërisht e saktë**<br><br>***1 pikë*** | GRAMATIKA<br>→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës)<br>***2 pikë***<br><br>DREJTSHKRIMI<br><br>→ respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)<br><br>***2 pikë***<br><br>***Gjithsej 4 pikë***<br>GRAMATIKA<br><br>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. | → renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij<br>***1 pikë*** | → përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike<br><br>***1 pikë*** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | gabimet semantike...)<br><br>**pjesërisht e saktë**<br>***- 1 pikë***<br>DREJTSHKRIMI<br><br>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)<br>**pjesërisht e saktë**<br>***- 1 pikë***<br>***Gjithsej 2 pikë*** | | |